

POLITIKA FISKALE DHE REDUKTIMI I VARFËRISË

Ky material shërben si një bazë për nxitjen e debatit lidhur me rolin e politikave fiskale në reduktimin e varfërisë.

Çështjet thelbësore që kërkohet të adresohen dhe ku mund të fokusohet debati janë:

Të ardhurat buxhetore

1. Zhvillimi ekonomik dhe gjenerimi i të ardhurave

Politika fiskale është e destinuar të luajë një rol kyç në perspektivën e zhvillimit të ekonomisë. Kjo jo thjesht nga fakti se pozicioni fiskal është një komponent i rëndësishëm përcaktues i stabilitetit makroekonomik. Argumenti thelbësor qëndron në faktin se aftësia e ekonomisë shqiptare për të gjeneruar të ardhura mbetet shumë e limituar. Megjithatë në termat e performancave të rritjes ekonomike Shqipëria ka ecur relativisht mirë në raport me ekonominë e rajonit, të dhënat provojnë se të ardhurat e buxhetit në raport me GDP janë në nivele më të ulëta.

Në fund të vitit 2001, të ardhurat buxhetore në raport me GDP për disa nga vendet e rajonit janë si më poshtë:

Shqipëria	23 për qind;
Rumania	31.5 për qind.
FYROM	35.3 për qind;
Bullgaria	40 për qind;

Një tjetër diferencë e rëndësishme në këtë 'gap' është dhe përbërja e të ardhurave. Për Shqipërinë, të ardhurat doganore vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në totalin e të ardhurave, në raport me vendet e tjera krahasuese:

Në fund të vitit 2001, të ardhurat doganore në raport me GDP dhe me totalin e të ardhurave të buxhetit për disa nga vendet e rajonit janë si më poshtë:

Shqipëria	2.2%	9.4%
FYROM	4.0%	11.2%
Rumania	1.1%	3.5%
Bullgaria	0.9%	2.2%

Implikimet e këtyre zhvillimeve theksohen në perspektivën e Shqipërisë në reduktimin e tarifave doganore¹, qoftë në perspektivën e hapësirës së lirë tregtare me vendet e rajonit, angazhimeve që burojnë nga anëtarësimi në OBT dhe procesi i integritimit në strukturat ekonomike e tregtare të Bashkimit Europian.

Ajo çfarë rezulton nga kjo analizë, është nevoja për të shqyrtuar burimet alternative të rritjes së të ardhurave.

2. Vështrim mbi strukturën e të ardhurave dhe burimet e mundshme të rritjes

Duke analizuar strukturën e të ardhurave, në fund të vitit 2001 sipas kategorive kryesore të të ardhurave, kemi:

	Totali të ardhurave nga taksat, % të GDP*	Tatimi mbi të ardhurat personale	Tatimi mbi fitimin	Kontributi sigurimeve shoqërore	Mallra dhe shërbime
Shqipëria	19.3	1.1	1.7	3.8	10.8
Bullgari	30.8	4.7	3.3	8.0	12.8
FYROM	25.0	3.9	0.8	9.2	11.1
Rumani	30.1	4.1	3.0	9.1	10.0
Hungari	38.7	6.5	2.2	13.9	15.1
Itali	42.7	10.7	3.0	12.2	13.0

(*shënim: totali të ardhurave nga taksat në të dhënat e mësipërme përfshin edhe kontributin e sigurimeve shoqërore)

Duke analizuar tendencat e vëzhguara që nga viti 1997, vihen re këto prirje:

- Në tërësi, të ardhurat buxhetore nga taksat janë rritur nga 16.6% në 19.3 % e GDP; megjithatë, niveli i tyre qëndron shumë më poshtë se vendet e marra në analizë (pa dyshim ky raport është shumë i përkeqësuar në raport me ekonomitë e vendeve të zhvilluara).
- Peshën kryesore në këtë kategori të të ardhurave buxhetore e zënë tatimet indirekte: VAT (30.8 për qind të të ardhurave totale nga taksat), të ardhurat doganore (9.4 për qind) dhe nga akcizat (7 për qind). Rritja në këtë kategori të të ardhurave ka ardhur veçanërisht nga rritja e të ardhurave nga TVSH, kryesisht nga rritja e normës së saj nga 12 për qind në 20 për qind. Megjithëse tendenca është e lehtë, të ardhurat nga taksa doganore janë në rënie, ndërsa të ardhurat nga akcizat kanë një rritje në krahasim me vitin 1997 dhe qëndrojnë thuhajse konstante që nga viti 1998. Norma e TVSH për disa vende është: Bullgaria – 20%; Kroacia – 22%; FYROM – 19%, 5% (produktet bujqësore, energji dhe transport); Rumania – 19% (0% për mallrat e investimit në zonat e lira).
- Tatimi mbi fitimin e kompanive zë 7.6 për qind të totalit të të ardhurave nga taksat, nga 4.6 për qind në vitin 1998. Norma e tatim fitimit² që aplikohet në Shqipëri është ulur që nga viti 2001 nga 30 në 25 për qind. Kjo normë është 15 për qind në FYROM, 18 për qind në Hungari, 25 për qind në Rumani, 20 për qind në Kroaci, etj.
- Tatimi mbi të ardhurat personale ka shënuar rritje: nga rreth 1 për qind të totalit të të ardhurave në vitet 97-98, në 4.6 për qind në vitin 2001. Shqipëria aplikon një

sistem progresiv në tatimin mbi të ardhurat personale. Niveli tavan është ulur në 25 për qind. Në vendet e tjera kjo varion nga 20 për qind në Jugosllavi, në 35 për qind në Hungari dhe FYROM. Që nga viti 1998, Shqipëria filloi dhe aplikimin e taksave mbi të ardhurat e krijuara nga investimet e depozituesve (të ardhurat nga interesat bankare) dhe investimet kapitale (mbi dividendët).

- Të ardhurat nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore përbëjnë 16.6 për qind të totalit të të ardhurave (ose 3.8 për qind të GDP), duke shënuar një rritje krejt të lehtë gjatë gjithë periudhës nga viti 1996. Normat e kontributit të sigurimeve shoqërore janë mjaft më të larta se tatimi mbi të ardhurat personale: mesatarisht punëdhënsi plus punëmarrsi paguajnë 35-45 për qind të fondit të pagave si kontribute. Deri në fund të vitit 2000, këto norma ishin: 44.2 për qind në Shqipëri (34.2 + 10); 39.7 për qind në Bullgari (31.9 + 7.8); 30.6 për qind në FYROM; deri në 48.5 për qind në Hungari (36 + 12.5).
- Një burim i rëndësishëm i financimit në rastin e vendit tonë janë dhe të ardhurat jotatimore që përbëhen thujse tërësisht nga transferim fitimi i Bankës së Shqipërisë. Në fund të vitit 2001, kjo kategori të ardhurash renditet e treta nga rëndësia (pas TVSH dhe të ardhurave nga taksat doganore): me 8.1 për qind të totalit të të ardhurave buxhetore, ose 1.85 për qind e GDP. Kujtojmë se kjo kategori e të ardhurave, e rezultuar kryesisht nga normat e larta të interesave bankare, do të tentojë të reduktohet vazhdimisht (0.5 për qind e GDP-së në vendet e zhvilluara). Kjo nga ana e saj rezulton në reduktim të një kategorie të rëndësishme të shpenzimeve qeveritare, pagimin e interesave, që në fund të vitit 2001 arrinte në 4 për qind të GDP.

Faktet e mësipërme ndriçojnë edhe disa nga çështjet për debat:

- Nivelet e taksave apo kontributeve, sipas gjithë kategorive të të ardhurave, duket se janë në limitet e mundshme.
- Niveli i taksave mbi konsumin (taksa regresive dhe që rëndojnë më shumë shtresat e varfra) nuk janë të diferencuara: a do të ishte e dëshirueshme një rikonsiderim për ulje ose vendosje në dy nivele të TVSH?
- Konsolidimi makroekonomik i vendit dhe proceset integruese tregtare, do të bëjnë që një pjesë e rëndësishme e të ardhurave buxhetore (tatimore dhe jo tatimore), të firojë.
- *Në këto kushte, cilat do të ishin rrugët për rritjen e nivelit të të ardhurave të buxhetit, për të përballuar nevojat në rritje për shpenzimet qeveritare për infrastrukturën sociale dhe fizike të vendit?*

3. Ekonomia informale dhe të ardhurat buxhetore

Një pengesë e rëndësishme në rritjen e të ardhurave buxhetore janë dimensionet e ekonomisë informale. Në materiale të ndryshme, shifra luhatet nga 40 deri në 60 për qind të GDP.

Duhet të theksohet se deri tani, nuk ka një studim të plotë të përmasave të ekonomisë informale, në gjithë dimensionet e shfaqjes së saj. Studime mbi tregun informal të punës, ofrojnë një shifër prej afërsisht 25 për qind, një shifër relativisht e konsiderueshme për dimensionet e tregut total të punës. Duke patur parasysh se këto vlerësime përmbedhin vetëm punësimin në të zezë, dhe është akoma më e vëshirë vlerësimi i plotë për shkak të nënraportimit të nivelit të pagave për punëtorët e përfshirë në sistem, dimensionet e këtij fenomeni janë edhe më të mëdha. Për rrjedhojë, edhe një burim i rëndësishëm i rritjes së të ardhurave nga sigurimet shoqërore, të cilat kanë tërhequr një pjesë të konsiderueshme të transfertave shtetërore (rreth 2% të GDP). Këto fonde mund të rialokoheshin në fushat e tjera të sektorit social dhe mbrojtjes sociale.

Evazioni fiskal (shmangia e subjekteve private nga pagimi i detyrimeve tatimore e doganore), përveç efekteve të rëndësishme në prishjen e strukturës ekonomike të vendit dhe deformimeve të tregut, ka krijuar një rrjedhje të pallogaritshme për financat e vendit. Edhe në këtë aspekt, nuk ka vlerësime të sakta të shkallës së evazionit. Përveç tregimeve andekdodike që hasen shpesh në faqet e shtypit, vlerësime serioze akoma nuk janë bërë. Disa vlerësime nga disa institute kërkimore³ theksojnë se **shifra e evazionit shkon në rreth 500 milionë dollarë në vit**, shifër kjo sa rreth 50% e të ardhurave totale të buxhetit të shtetit.

Siç mund të shihet nga të dhëna të tilla, mundësia për rritjen e të ardhurave shtesë në buxhet nga reduktimi/eliminimi i ekonomisë informale janë një burim i rëndësishëm, madje ndoshta, në nivelet aktuale të normave të taksave, dhe i vetmi.

4. Aspekte administrative të sistemit tatimor

Ndërsa në aspektin legjislativ përpjekjet janë materializuar në krijimin e një kuadri ligjor fiskal të standardeve të përparuara, reformat institucionale në krijimin e një administrate fiskale⁴ moderne, eficiente dhe transparente, kanë provuar të jenë mjaft më të vështira.

Është për këto arsye që, barazia e subjekteve në pagimin e detyrimeve nuk është respektuar. Media ka dhënë mjaft shembuj të firmave, shpesh edhe të mirënjohura, të cilat vazhdojnë prej vitesh të raportojnë humbje, duke shmangur pagimin e detyrimeve tatimore.

- Inspektorët tatimor nuk kanë autoritetin e duhur për të vendosur barazinë e subjekteve tatimore dhe nuk janë zhvilluar mekanizma që të sigurojnë këtë barazi, edhe për firmat e regjistruara, ndërkohë që numri i firmave që ushtrojnë veprimtari ekonomike të paregjistruar mbetet tepër i lartë. Megjithëse është e vështirë të kuantifikohet në shifra, fakti që në mjetet e medias pasqyrohen aksione (sporadike) të policisë tatimore dhe sekuestime të pasurisë së firmave të tilla, janë evidenca të faktit që mekanizmat e qëndrueshëm të kontrollit nuk janë të zhvilluara. Nga ana tjetër, pagimi në paradhënie e tatim fitimit nga ana e kompanive, duket një procedurë që shpesh rezulton diskriminuese. Vetë firmat ankohen se pagimi detyrimeve tatimore bazohet më tepër në planin e të ardhurave të buxhetit dhe jo në treguesit real të fitimprurjes së aktivitetit. Rimbursimi TVSH vazhdon të mbetet një problem kronik duke i vënë aktivitetet e subjekteve në vështirësi likuiditeti.

- Sistemi i auditimit të bilanceve kontabël ka vazhduar të mbetet kronikisht abuziv, duke krijuar vështirësi për autoritetet tatimore. Auditimi nga autoriteti tatimor është e pamundur të mbulojë 100 për qind të firmave të regjistruara. Nga ana tjetër, përgjegjësia e ekspertëve kontabël në certifikimin e bilanceve të firmave është thellësisht e pazhvilluar;
- Procedurat doganore krijojnë hapsira të mëdha për subjektivizëm nga agjentët doganor⁵, gjë që krijon kosto shtesë tek biznesi.

Në tërësi, klima e bashkëpunimit midis institucioneve tatimore e doganore dhe biznesit vazhdon të mbetet mosbesuese. Nga njëra anë, subjektet ankohen që pengohen nga autoritetet fiskale nëpërmjet procedurave subjektive, arbitrare dhe diskriminuese, nga ana tjetër, shumë firma vazhdojnë të kryejnë aktivitet ekonomik jashtë sistemit fiskal.

Shpenzimet buxhetore

1. Vështrim i përgjithshëm në ecurinë e shpenzimeve qeveritare

Nivelet e ulëta të të ardhurave buxhetore dhe rritjet e ndjeshme e borxhit publik, kanë ushtruar presione për axhustim fiskal, duke ndikuar në reduktimin e vazhdueshëm të shpenzimeve qeveritare. Në terma real, rritja e shpenzimeve ka filluar vetëm pas vitit 2000.

Ashtu si dhe të ardhurat buxhetore, shpenzimet qëndrojnë nën nivelin mesatar të ekonomive në tranzicion. Kjo diktoi reduktim të shpenzimeve në gjithë kategoritë, ku i vetmi zë i rritur mbetet pagimi i interesave (25.3 për qind e shpenzimeve buxhetore në vitin 1998 duke rënë në 12.7 për qind në vitin 2001), për shkak të normave të larta të interesave bankare.

Nga pikëpamja e menaxhimit më efektiv dhe strategjik të shpenzimeve qeveritare, duke filluar nga viti 2001 filloi të aplikohet Programi Afatmesëm Buxhetore (PAB). Ky dokument shërben si një orientim i rëndësishëm në ruajtjen e disiplinës fiskale, priorizimit të shpenzimeve publike duke i lidhur ato më mirë me politikën qeveritare dhe duke inkurajuar një eficiencë më të madhe teknike në alokimin dhe përdorimin e burimeve financiare.

2. Struktura e shpenzimeve

	1998	1999	2000	2001
Totali shpenzimeve, % GDP	30.8	32.7	31.6	31.5
Kategoritë kryesore të shpenzimeve, në raport me totalin e shpenzimeve (% of GDP)				
I. Shpenzime korrente	82.9 (25.5)	79.1 (25.9)	78.1 (24.7)	75.7 (23.8)
1. Personeli	20 (6.2)	18.8 (6.2)	19.5 (6.2)	22.1 (7)
2. Interesat	25.3 (7.8)	21.1 (6.9)	17.3 (5.5)	12.7 (4)
3. Shpenzime operimi & mirëmbajtje	13.1 (4)	12.1 (4)	11.3 (3.6)	8.5 (2.7)
4. Subvencione dhe sigurime sociale	17.2 (5.3)	20.5 (6.7)	21.9 (6.9)	23.4 (7.4)
II. Shpenzime kapitale	17.1 (5.3)	20.6 (6.7)	21.3 (6.7)	23.3 (7.4)

(Ministria e Financave⁶, 2001)

- *Shpenzimet e personelit*

Si rrjedhojë e reformës në administratën publike, punësimi në shërbimin publik është reduktuar në mënyrë të vazhdueshme. Për rrjedhojë, edhe shpenzimet për pagat kanë shënuar rënie, deri në fund të vitit 2000, megjithëse pagat janë rritur (në terma nominal) me rreth 50 për qind në vitin 2000, kundrejt vitit 1996. Në analizën e shifrave, rritja pas vitit 2000 në këtë kategori lidhet përveç reformës në rritjen e pagave (me rritje më të theksuara për sektorët e mbrojtjes, drejtësisë dhe policinë), edhe me riklasifikimin e ‘bonuses’ (rreth 0.5 për qind e GDP) që më parë përfshihej në shpenzimi operimi & mirëmbajtje.

- Megjithëse në projeksionet buxhetore rritjet e pagave për sektorët e shëndetësisë dhe arsimit, si dy sektorë të konsideruar si prioritarë në reduktimin e varfërisë, janë konsideruar me ritme më të larta se sektorët e tjerë, rimet e rritjes së tyre duhet të jenë më të larta. Në raport me pagat në sektorët e tjerë të shërbimit civil, pagat në këto dy sektorë vazhdojnë të jenë më të ulëta. Nivelet e pagave në këto sektorë janë evidentuar në GPRS si elementë kritikë të shkaqeve që kanë cuar në rënien e nivelit arsimor dhe mungesën e trajtimit mjekësor, vecanërisht në zonat rurale.

- *Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes.*

Megjithëse shpenzimet për kategori në PAB janë parashikuar të rriten (me ritmet e rritjes së GDP), nivelet e tyre konsiderohen si të pamjaftueshme për të përballuar mirëmbajtjen e infrastrukturës, për shkak të disbalancave midis fondit të pagave dhe mallrave dhe shërbimeve. Në shumicën e rasteve, shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes zënë më pak se 15 për qind të shpenzimeve korrente.

Për rrjedhojë, infrastruktura fizike është jo e mirëmbajtur dhe përkeqësohet me shpejtësi. Ndërsa cilësia e shërbimeve publike ndikohet nga mungesa e pajisjeve dhe materialeve bazë të nevojshme.

Kjo po bëhet një çështje kritike edhe për mundësitë e mirëmbajtjes së infrastrukturës fizike të rindërtuar me financimet e donatorëve. Për këtë arsye, PAB parashikon një rritje deri në 3.9 për qind në vitin 2004, e adresuar kryesisht në sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe infrastrukturës fizike.

- *Subvencionet dhe transfertat për mbrojtjen sociale.*

Subvencionet kanë përfshirë tekset mësimore, transportin hekurudhor dhe urban, sistemin kullues (bujqësi) dhe programet e nxitjes së punësimit (për punëdhënësit). Megjithëse subvencionet zinin vetëm 0.4 për qind të GDP në vitin 1996, për shkak të krizës energjitike (subvencionimit të cmimit të energjisë së importit), ato arritën në 1.2 për qind të GDP në vitin 2001.

Megjithëse masat e ndërmarra nga KESH pritet të përmirësojnë situatën e arkëtimeve nga debitorët, ndërmarrjet e shërbimeve publike (vecanërisht ndërmarrjet e ujit) janë debitore të KESH. Kjo mund të rezultojë në shtim të subvencioneve për to. Në tërësi, kjo kategori shpenzimeve pritet të reduktohet deri në 0.3 për qind të GDP deri në vitin 2004.

Transfertat e mbrojtjes sociale lidhen kryesisht me skemat e pensioneve. Qëndrueshmëria financiare e ISSH prej kohësh varet në masën më të madhe nga transfertat fiskale. Numri i kontribuesve është shumë i ulët, dhe i atyre nga sektori privat bujqësor zë më pak se 20 për qind të totalit të kontribuesve në sistem. Dy masat e marra kohët e fundit nga qeveria (rritja e moshës së pensionit dhe reduktimi normës së kontributit e kombinuar me rritjen e kufirit të pagës për llogaritjen e kontributit), pritet të japin rezultate në përmirësimin e performancave të skemës së sigurimeve. Këto masa, së bashku me nxitjen e pjesëmarrjes në skemat vullnetare të sigurimeve dhe fuqizimin e kontrollit administrativ dhe bërjen operacional të numrit të sigurimit, pritet të bëjnë që pesha e transfertave buxhetore të bjerë në rreth 1.4 për qind të GDP deri në fund të vitit 2004 (nga rreth 2 për qind aktualisht).

Hapësira ekzistojnë gjithashtu edhe në targetimin më të mirë të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike. Sistemet më të mira të kontrollit dhe decentralizimi gradualisht i tyre pranë autoriteteve lokale, kanë bërë të mundur uljen e numrit të këtyre familjeve përfituese dhe rritjen e përfitimeve për shtresat realisht në nevojë.

- *Investimet publike*

Kanë shënuar një rritje të qëndrueshme duke arritur në 7.4 për qind në vitin 2001. një problem i vazhdueshëm mbetet përfshirja e financimeve të huaja në sistemin buxhetor. Vlerësohet⁷ se rreth 30 për qind e financimeve të huaja akoma mbeten të paraportuara, gjë që krijon vështirësi në menaxhimin financiar, shtyrje të projekteve (për shkak të mosalokimit të fondeve të pjesë lokale, si mbulimi TVSH, etj) dhe mungesë të transparencës.

Sidoqoftë, problemet thelbësore në investimet publike mbeten:

- Mungesa e kapaciteteve profesionale brenda ministrive të linjës në planifikim dhe buxhetimin e projekteve;
- Praktikrat e trashëguara të ndarjes së buxheteve në bazë vjetore dhe jo sipas kostove totale të projekteve;
- Mungesa e informacionit të konsoliduar për projektet me financime të huaja dhe të brendshme;
- Projektet e investimeve nuk kanë procedura të qarta dhe transparente të kostove bazë dhe teknikave të llogaritjes. Për rrjedhojë, ekzistojnë mundësi për reduktime në kostot e projekteve individuale dhe rritjen e numrit të projekteve.
- Mekanizmat e monitorimit të projekteve, veçanërisht të projekteve infrastrukturore mbeten mjaft të dobëta, gjë që jo rrallë ka krijuar probleme në cilësinë e dobët të punimeve në projektet e financuara, vonesa dhe zvarritje në përfundimin e projekteve në afatet e parashikuara; kërkesa për shtesa fondesh për shkaqe të ndryshme, etj.

Këto dobësi u vunë re edhe gjatë procesit të hartimit të GPRS, ku në tërësi, asnjë nga ministritë e linjës nuk ishte në gjendje të jepte implikimet buxhetore për masat e propozuara si veprime qeveritare të përfshira në program.

Nga pikëpamja sektoriale, është e rëndësishme të evidentohen shpenzimet në arsim, shëndetësi dhe mbrojtjen sociale.

Shpenzimet për arsimin mesatarisht në 3.2 për qind të GDP janë dhe më të ulëta se në vendet me të ardhura nën nivelin mesatar (4.8 për qind e GDP). Ndërsa në shëndetësi shpenzimet publike llogariten në rreth 2 për qind të GDP-së, ose sa 2/3 e këtij niveli në vendet me të ardhura nën nivelin mesatar. Niveli i ulët e shpenzimeve publike është reflektuar dhe në përkeqësimin e shërbimit publik në të dy sektorët, duke ndikuar drejtpërdrejt dhe në rritjen e nivelit të varfërisë (të matur me këto tregues).

I konsideruar në dokumentin e GPRS si një orientim i rëndësishëm në reduktimin e varfërisë, programi buxhetor i ka dhënë prioritet rritjes së shpenzimeve në këto sektorë, të programura të arrijnë në respektivisht 3.7 dhe 3.2 për qind të GDP-së deri në vitin 2004.

Decentralizimi fiskal

Procesi i decentralizimit fiskal dhe kalimit të përgjegjësive pranë autoriteteve lokale, është një fenomen i ri dhe që ka marrë zhvillim pas vitit 1999. Të ardhurat e pushtetit lokal zënë vetëm 0.35 për qind të GDP-së në vitin 2001, të cilat grumbullohen kryesisht nga autoritetet fiskale qendrore dhe i jepen autoriteteve vendore në formën e granteve të pakushtëzuara.

Disa taksa vendore aktualisht janë në proces të kalimit për tu grumbulluar nga vetë autoritetet vendore, si taksa mbi biznesin e vogël, taksa mbi tokën bujqësore (që pritet të aprovohet gjatë këtij viti). Besohet se kalimi i këtij funksioni pranë autoriteteve vendore do të ndikojë pozitivisht në rritjen e të ardhurave. Argumenti kryesor është shkalla më e

lartë e njohjes së bizneseve në nivele lokale dhe rrjedha më transparente e informacionit. Ky është një proces që ka gjithashtu edhe kosto. A nuk është ndoshta e nevojshme që të bëhen vlerësime më të sakta dhe të studjuara për këto masa të pritshme? Në çdo rast, kalimi këtyre funksioneve duhet të ecë gradualisht me përgatitjen e administratës së ardhshme lokale për të qenë e aftësuar marrjen përsipër të tyre.

Burimet kryesore ekonomike në ushtrimin e funksioneve të tyre ekskluzive (mirëmbajtje rrugësh lokale, ndricim rrugësh dhe shërbime publike, planifikimi urban, transporti urban, grumbullimi dhe përpunimi mbeturinave, furnizimi ujit pijshëm, aktivitetet kulturore e sportive dhe shërbimet e zhvillimit ekonomik lokal) janë siguruar kryesisht nëpërmjet alokimit të fondeve nga buxheti qendror. Problemet e shfaqura në këtë drejtim janë kapacitetet e pazhvilluara lokale për parashikimin e nevojave financiare sipas nevojave reale.

Një tjetër aspekt i decentralizimit përfshin dhe zhvillimin e funksioneve të përbashkëta midis autoriteteve lokale dhe qendrore, si në fushën e asrimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, rendit publik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Zhvillimi këtyre funksioneve janë kryesisht iniciativa sektoriale dhe vetë ministritë e linjës është e nevojshme që të koepojnë me autoritetet lokale për zhvillimin e programeve të përbashkëta.

Selami Xhepa

Shtator 2002

¹ Megjithatë, disa studime provojnë një korrelacion pozitiv mes reduktimit të tarifave doganore dhe të ardhurave buxhetore doganore. Shih p.sh., Ahmet Mancellari, Hasan Mytkolli, 2002, “Fiscal Constraint and Trade Liberalization – the Case of Albania”, Bamberg University, Public Economic Series, Volume 1. Sidoqoftë, vlerat positive të korrelacionit që derivojnë nga analizat e regresionit në modelin që autorët kanë ndërtuar, mund të interpretohen më tepër si reduktim i evazionit doganor për shkak të reduktimit të niveleve të tarifave.

² Shih: Jean Tesche, 2001 “The Role of State in South East Europe – Fiscal Issues”, draft-paper.

³ Shih psh, citim nga “Albanian Economic Review” nr.1, ku jepet citim për një studim që ekziston, por metodologjia e matjes nuk shprehet.

⁴ Kjo pjesë do të trajtohet dhe diskutohet në mënyrë më të detajuar në një paper tjetër “Governance and Institutions” për këtë raund konsultimesh.

⁵ Shih psh, evidenca të ofruara nga studimi “Obstacles to Trade, Growth, Investment and Competitiveness”, Balkan Network, September 2001 (www.balkannetwork.org).

⁶ Analiza e mëposhtme bazohet në të dhënat dhe problemet e identifikuara nga MTEF/2002-2004. Aktualisht, ky dokument është në proces *up-date*.

⁷ Shih: Ministria e Finacave, MTEF/2002-2004, June 2001.